



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:252577

Datë: 31.10.2024

Numri i dokumentit: 06379679

Në çështjen juridike të :

**AC-I-23-0583-A0001**

*Paditësi/Ankuesi*

**B S Ferizaj**, me përfaqësues avokatin D B, Ferizaj

**Kundër:**

*E paditura*

**N.SH. “Eurometal”**, (në likuidim), me përfaqësuese **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, rr. “Dritan Hoxha”, nr.55, Lakrishte, Prishtinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani, gjyqtar kryesues, Ilmi Bajrami dhe Shkelzen Sylaj, gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës të paraqitur kundër Aktgjykimit të shkallës së parë të DHPGJS-së, C-IV-14-6624, të datës 21 shtator 2023, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 31 tetor 2024, lëshon këtë:

## **A K T G J Y K I M**

1. Ankesa e të paditurës refuzohet si e pabazuar.
2. Vërtetohet Aktgjykimi i shkallës së parë të DHPGJS-së, C-IV-14-6624, i datës 21 shtator 2023.
3. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.

## **Rrethanat procedurale dhe faktike**

Me datë 21 tetor 2014, paditësi kishte parashtruar një padi kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit (AL) me nr. GJI057-0203 të datës 16 korrik 2013, me të cilin vendim kërkesa e paditësit për kompensim për paga të papaguara në shumën prej 946.00 euro për periudhën maj-tetor 1990, ishte refuzuar si e pavlefshme për faktin se duke vërejtur mungesën e informacioneve të plota mbi kërkesën me datë 26 prill 2014, AL i dërgoi parashtruesit të kërkesës një kërkesë për informacione shtesë. AL kishte vërejtur se parashtruesi i kërkesës nuk e ka paraqitur vendimin e gjykatës që i kërkohej nëpërmjet kërkesës për informacione shtesë. Rrjedhimisht AL konsideron se dokumentacioni për kërkesën ka mbetur i paplotë në kuptimin e nenit 36.2.2 të Shtojcës së Ligjit për AKP-në dhe për këtë arsye e kishte refuzuar kërkesën si të pavlefshme.

Në ankesë paditësi kishte theksuar se paditësi ka qenë në marrëdhënie pune të përhershme në N.SH por paditësit pa bazë ligjore nuk i janë paguar të ardhurat personale prej maj-tetor 1990, ndërsa në muajin nëntor paditësi si dhe punëtorët tjerë kanë qenë të larguar nga puna me një vendim arbitrar e të kundërligjshëm nga Këshilli i përkohshëm i Ndërmarrjes. Pas largimit të dhunshëm të paditësit dhe punëtorëve të tjerë nga puna paditësi kishte ushtruar padi në gjykatën kompetente kundër Aktvendimit mbi largimin nga puna dhe për pagesën e pagave duke përfshirë edhe pagesën e pagave të papaguara. Pasi që padia e paditësit nuk është zgjidhur si dhe paditë tjera të paditësve në mënyrë meritore edhe pse nuk është kontest fakti se ata kanë punuar deri në tetor të vitit 1990 paditësit nuk iu janë paguar pagat mujore prej majit e deri në tetor 1990. E ky fakt është vërtetuar edhe me shkresën zyrtare të fabrikës së Këmbyesve “FAKNIT” e datës 6 maj dhe 7 maj 1991. Andaj, paditësi i kishte propozuar gjykatës që të aprovet në tërësi si e bazuar kërkesëpadija e paditësit dhe të detyrohet e paditura që t’i paguaj paditësit shumën prej 946.00 euro për periudhën maj-tetor 1990.

Ankesës i kishte bashkëngjitur një kërkesë për lirim nga pagesa e taksës gjyqësore, vendimin e ankimuar të AL-së me nr. GJI057-0203 të datës 16 korrik 2013, një shkresë për gjykatën nga paditësi e datës 15 tetor 2014, regjistrin e punëtorëve (listën e pagave) për realizimin e borxhit të mbetur pranë N.SH-së për muajt maj-tetor 1990 (punëtorët aktiv pas vitit 1999), një propozim drejtuar Gjykatës Themelore të Punës së Bashkuar të datës 4 shkurt 1991, një Njoftim të Gjykatës Themelore në Ferizaj të datës 10 maj 2013, listën e pagave të papaguara dhe të paguara të të ardhurave personale për punëtorët e N.SH-së për vitin 1990, e datës 7 maj 1991, autorizimin për përfaqësim, një informatë të datës 2 tetor 1990 nga anëtarët e Sindikatës së Pavarur N.SH

“FAKNIT”, një shkresë e N.SH-së e datës 6 maj 1991, si dhe një Aktvendim të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë me nr. Ac.nr.251/2006 të datës 21 janar 2008.

Me datë 6 prill 2023, AKP-ja kishte paraqitur mbrojtjen e saj në të cilën kishte theksuar se parashtruesi nuk ka treguar se cili nen i Ligjit 04/L-034 është shkelur nga Autoriteti i Likuidimit në marrjen e vendimit dhe në këtë mënyrë ka shkelur nenin 74.2 të Ligjit 06/L-086 i cili parashikon që ankesat e dorëzuara në DHPGJS kundër vendimeve të Autoritetit të Likuidimit duhet të bazohen në pretendimin se procesi i likuidimit nuk është kryer në përputhje me Ligjin për AKP-në. AL kishte vërejtur se parashtruesi i kërkesës nuk e ka paraqitur vendimin e gjykatës që i kërkohej nëpërmjet kërkesës për informacione shtesë, rrjedhimisht AL konsideron se dokumentacioni për kërkesën ka mbetur i paplotë dhe për këtë arsye kërkesa i është refuzuar. AL nuk ka kompetenca ligjore për të vlerësuar ligjshmërinë e vendimeve të gjykatave dhe është i detyruar t’i refuzoj kërkesa e tilla në bazë të nenit 36.1 të Shtojcës së Ligjit për AKP-në. Andaj i kishte propozuar gjykatës që të refuzoj ankesën si të papranueshme dhe të vërtetoj vendimin e Autoritetit të Likuidimit. Mbrojtjes i kishte bashkëngjitur vendimin e ankimuar të AL-së me nr. GJI057-0203 të datës 16 korrik 2013 si dhe vendimin për emërimin e anëtarëve të Autoritetit të Likuidimit.

Me datë 11 shtator 2023, paditësi kishte paraqitur një parashtresë me të cilën kishte bërë precizimin e kërkesëpadisë lidhur me shpenzimet e procedurës dhe kishte kërkuar nga gjykata që përpos kompensimit të shumës për paga të papaguara t’i paguaj paditësit edhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej 21.00 euro dhe 104.00 euro si dhe shpenzimet eventuale të cilat mund të krijohen më vonë.

Me datë 21 shtator 2023, shkalla e parë e DHPGJS-së me Aktgjykimin C-IV-14-6624 kishte aprovuar si të bazuar ankesën e ankuesit dhe kishte ndryshuar vendimin e AL-së, ashtu që kishte obliguar të paditurën që ankuesit në emër të kompensimit për paga të papaguara t’i paguaj shumën prej 946.00 euro dhe shpenzimet e procedurës në shumën prej 124.00 euro. Në arsyetimin e këtij Aktgjykimi ishte theksuar se nga njoftimi Ref.nr.Gj.A.nr.414/2019 i datës 10 maj 2013 të lëshuar nga Gjykata Themelore në Ferizaj vërtetohet se lëndët me të cilat punëtorët kanë kërkuar aktgjykim nga Gjykata Themelore në Ferizaj ishin të regjistruara dhe të pakryera. Me kopjen e propozimit për pagimin e të ardhurave personale drejtuar Gjykatës Themelore të Punës së Bashkuar vërtetohet se në mesin e propozuesve gjendet edhe emri i ankuesit B S Poashtu edhe me regjistrin e punëtorëve për realizimin e borxhit të N.SH-së të mbetur për vitin

1990 për muajt maj-tetor 1990 shihet se ankuesit N.SH i kishte mbetur borxh shumë prej 946.00 euro. Gjithashtu, me shkresën nr.23 të datës 10 maj 2013 e cila përmban vulën e N.SH-së dhe është e nënshkruar nga R Sh i autorizuar e cila iu ka drejtuar AKP-së, vërtetohet fakti se 105 kreditor në emër të pagave të papaguara nga N.SH “Faknit” më vonë me emrin “Eurometal” për periudhën maj-dhjetor 1992 kanë kërkuar pagesën e tyre me kërkesë të përbashkët. Gjithashtu kishte shtuar se kërkesa e punëtorëve është dorëzuar në Gjykatën Themelore të Punës së Bashkuar dhe se punëtorët kishin paraqitur kërkesë në AKM në korrik të vitit 2004. Andaj, gjykata i kishte pranuar këto si prova relevante dhe të bazuara për të arritur në përfundim se ankuesi ka ofruar shërbime punë për N.SH për periudhën maj-tetor 1990 dhe se për këtë periudhë i takon kompensimi për paga të papaguara në shumë prej 946.00 euro. E paditura nuk kishte dëshmuar të kundërtën dhe as nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të vërtetuar faktin se ankuesi nuk kishte ofruar shërbime pune për N.SH-në apo se nuk i takon kompensimi për paga.

Me datë 12 tetor 2023, e paditura (ankuesja) kishte paraqitur një ankesë kundër Aktgjykimit C-IV-14-6624 të datës 21 shtator 2023 (aktgjykimi i ankimuar), duke i propozuar Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së që të ndryshoj Aktgjykimin e ankimuar duke refuzuar ankesën e paditësit ndaj vendimit të Autoritetit të Likuidimit dhe duke vërtetuar këtë të fundit. Në ankesë theksohet se gjykata gjatë shqyrtimit të çështjes ka ngatërruar dy çështje krejtësisht të ndryshme nga njëra tjetra dhe atë dy afatet e parashkrimit të cilat Autoriteti i Likuidimit është i obliguar t'i pranojë dhe përmes të cilave aplikon në mënyrë të drejtë ligjin. Afati i parë ka të bëjë me afatin për parashtrim të kërkesave që është afat për të dorëzuar një dëshmi të kërkesës në procedurën e likuidimit, ndërsa afati i dytë ka të bëjë me natyrën (meritat) e së drejtës të cilën parashtruesi ka kërkuar ta zbatoj në kërkesë. Këto dy afate duhet të përmbushen nga një kreditor në mënyrë që kërkesa e tij të pranohet e nëse një kreditor dështon të përmbushë një prej këtyre afateve, kërkesa e tij do të refuzohet pavarësisht faktit se ai ka përmbushur afatin tjetër. Tutje, pala kundërshtare sqaron gjykatën se njoftimi që i referohet parashtruesi e informon atë se ai ka të drejtë të parashtrorë kërkesën pranë AKP-së dhe se kërkesa të tilla do të shqyrtohen në likuidim. Duke injoruar plotësisht parashtruesin e palës kundërshtare dhe argumentet e saj në mbrojtje, Aktvendimi nuk përmbushë aspak detyrimin e shprehur në nenin 54 të Ligjit nr. 06/L-086 për Dhomën e Posaçme mbi nevojën e analizës së provave dhe parashtrësive të prezantuara gjatë procedurës. Autoriteti i Likuidimit fton DHPGJS-në që të lëshohet edhe njëherë në shqyrtim të çështjes në fjalë dhe të konsideroj argumentet e Autoritetit të Likuidimit që kanë të bëjnë me kufizimet e të drejtave të parashtruesve e që këto kufizime Autoriteti i Likuidimit është i obliguar që t'i zbatoj Ex officio. Ankesës i kishte bashkëngjitur vendimin e ankimuar të AL-së.

Me datë 15 maj 2024, paditësi kishte paraqitur përgjigje në ankesën e të paditurës në të cilën i kishte propozuar gjykatës që të refuzohet si e pabazuar ankesa e të paditurës dhe të vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

### **Arsyetimi i ligjor**

Ankesa e të paditurës është e pabazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

### **Meritat e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit**

Aktgjykimi i ankimuar shkallës së parë të DHPGJS, është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor, andaj duhet të vërtetohet.

Kolegji i Apelit vëren se kërkesa e paditësit për paga të papaguara për periudhën maj-tetor 1990 në shumën prej 946.00 euro, ishte refuzuar si e pavlefshme për faktin se AL kishte konsideruar se dokumentacioni për kërkesën drejtuar paditësit ka mbetur i paplotë në kuptimin e nenit 36.2.2 të Shtojcës së Ligjit për AKP-në.

Kolegji i Apelit ka vërejtur se paditësi në shkallë të parë kishte bashkëngjitur këto prova: një shkresë për gjykatën nga paditësi e datës 15 tetor 2014, regjistrin e punëtorëve (listën e pagave) për realizimin e borxhit të mbetur pranë N.SH-së për muajt maj-tetor 1990 (punëtorët aktiv pas vitit 1999), një propozim drejtuar Gjykatës Themelore të Punës së Bashkuar të datës 4 shkurt 1991, një Njoftim të Gjykatës Themelore në Ferizaj të datës 10 maj 2013, listën e pagave të papaguara dhe të paguara të të ardhurave personale për punëtorët e N.SH-së për vitin 1990, e datës 7 maj 1991, autorizimin për përfaqësim, një informatë të datës 2 tetor 1990 nga anëtarët e Sindikatës së Pavarur N.SH “FAKNIT”, një shkresë e N.SH-së e datës 6 maj 1991, si dhe një Aktvendim të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë me nr. Ac.nr.251/2006 të datës 21 janar 2008.

Shkalla e parë e DHPGJS, pas shqyrtimit të provave dhe shkresave të lëndës, kishte nxjerrë Aktgjykim me të cilin i kishte njohur paditësit të drejtën në kompensim të pagave të papaguara për periudhën maj-tetor 1990 në shumën prej 946.00 euro me arsyetimin se i njëjti kishte dorëzuar prova relevante që dëshmonin se N.SH në fjalë ka detyrim ndaj paditësit.

Kolegji i Apelit në rastin konkret vlerëson se shkalla e parë e DHPGJS-së kishte vepruar drejtë me rastin e marrjes së vendimit, ndërsa konsideron se ankesa e të paditurës është e pabazuar.

Kjo për faktin se ankesa e ankuesit nuk mund të konsiderohet e parashkruar për faktin se i njëjti kishte parashtruar një provë, një propozim drejtuar Gjykatës Themelore të Punës së Bashkuar të datës 4 shkurt 1991, sipas të cilës paditësi ndër shumë të tjerë kërkonin pagat e pa paguara që nga muaji maj deri në tetor 1990.

Sipas deklaratës së tij në padi, ai me shumë të tjerë ishte larguar nga puna në nëntor të së njëjtit vit.

Gjithashtu me njoftimin e saj të datës 10 maj 2013, Gjykata Themelore në Ferizaj kishte konfirmuar ekzistimin e padisë por e cila akoma nuk ishte zgjedhur. Me këtë njoftim vërtetohet se organet kompetente kishin pranuar faktin se ndaj punëtorëve në fjalë në mesin e të cilëve ishte edhe paditësi nuk ishte paguar për pagat për muajt e kërkuar.

Kolegji i Apelit vëren se lista e pagave e dorëzuar nga paditësi, ku i njëjti mban numrin rendor 72 vërtetohet fakti se N.SH i kishte mbetur borxh pagat e papaguara në shumën prej 986.00 euro për periudhën maj-tetor 1990, mirëpo shuma e kërkuar nga paditësi pranë AL-së është 946.00 euro.

Kjo listë dhe shuma e kërkuar nga paditësi nuk është kontestuar asnjëherë nga e paditura (AKP), andaj faktet e pakontestuar konsiderohen të vërtetuara dhe në rastin konkret nuk është kontestuese se paditësit i takon kompensimi në fjalë në shumën dhe për periudhën e pretenduar.

Sa i përket pretendimeve të së paditurës në ankesën e saj të paraqitur në shkallë të dytë, Kolegji i Apelit vlerëson se ashtu siç me të drejtë thekson shkalla e parë, e paditura nuk ka paraqitur asnjë argument me të cilin do të dëshmonte të kundërtën e asaj që ka provuar paditësi, pra për të vërtetuar faktin se paditësit nuk i takon kompensimi në fjalë.

Prandaj, duke u bazuar në këto që u thanë më lart, Kolegji i Apelit konsideron se shkalla e parë ka vepruar drejtë kur paditësit i ka njohur të drejtën në kompensim të pagave të papaguara për periudhën dhe shumën e pretenduar si më lartë.

Nga arsyet e cekura më lartë, ankesa e të paditurës refuzohet si e pabazuar dhe vërtetohet Aktgjykimi i ankimit si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Nga se u tha më sipër në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së është vendosur si në dispozitiv.

### **Taksat gjyqësore**

Ankuesi tashmë e ka paguar taksën gjyqësore për procedurën ankimore me datë 26 tetor 2023, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 31 tetor 2024.

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar Kryesues

\_\_\_\_\_